



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo




Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-00049042-2/24 dt. 31.07.2024

Mitrovicë



Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 18 paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 dhe nenin 46 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 31.07.2024, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin Nr.02-400/01-00034131/24 dt. 21.05.2024 Për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-00038627-2/24 dt. 18.06.2024) sjell këtë:

VENDIM

Për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut

1. MIRATOHET Vendimi për lejimin e mjeteve financiare nga subvencionet si ndihmë për familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, ekonomitë familjare të cilat kanë pësuar dëme nga vërshimet dhe shembja e dheut dhe janë vlerësuar dhe evidentuar nga Komisioni i Komunës për vlerësim dhe verifikim të dëmeve sipas Raportit Nr. 02-052/01-0006238/24 dt. 26.01.2024, do të subvencionohen në shumë prej 10,000.00 (dhjetëmijë) €.
3. Mjetet e lejuara sipas pikës 2, të këtij vendimi ipen nga kategoria ekonomike Subvencione dhe transfere të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencja, dhe paguhen në xhirollogaritë personale të të dëmtuarve sipas Listës së dëmeve në ekonomi familjare (shtëpi të dëmtuara) të evidentuara në Raportin e Komisionit të Komunës për vlerësim dhe verifikim të dëmeve Nr. 02-052/01-0006238/24 dt. 26.01.2024.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit të Komunës për vlerësim dhe verifikim të dëmeve Nr. 02-052/01-0006238/24 dt. 26.01.2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencja dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
DSE dhe DBF



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	29.05.2024
REFERENC-Ë:	02-400/01-0034131/24
PËR/ZA/TO:	znj. Vesa BROJA ,Kryesuese e Kuvendit të Komunës.
CC:	Anetaret e Kuvendit të Komunes, Komiteti për Politik dhe Financa,
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bedri HAMZA, Kryetar i Komunes
NGA:	Bahtir MAXHUNI, Drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim-Vendim për Lejim të mjeteve Financiare nga Subvencionet për Familjet e prekura nga vërshimet në Komunën e Mitrovicës së Jugut

Bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 77, paragrafi I.10, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Kryetari i Komunës i propozon, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit Komunal këtë:

PROPOZIM-VENDIM

(Për Lejim të mjeteve Financiare nga Subvencionet për Familjet e prekura nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. I **propozohet** Kuvendit të Komunës përmes Komitetit për Politik dhe Financa që të lejoj shfrytëzimin e mjeteve financiare si ndihmë për Ekonomi Familjare në lagjen Bair që kanë pësuar dëme nga vërshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas listës së komisionit.

2. Të gjitha Ekonomitë Familjare të cekura në pikën 1 (një) të këtij Propozimi, që kanë pësuar dëme nga vërshimet dhe shembja e dheut, dhe janë vlerësuar nga Komisioni i Komunës për vlerësim dhe verifikim të dëmeve do të subvencionohen në shumën prej 10.000.00 € (dhjetëmijë euro).
3. Pagesa për familjet përfituese si në pikën 2 (dy) të këtij Propozimi do të bëhet nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë.

A R S Y E T I M

Kryetari i Komunës pas situatës së fundit që ka prekur banorët e lagjes Bair në Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe duke marrë për bazë faktin që janë shkaktuar dëme të mëdha nga vërshimet dhe shembja e dheut, dhe gjendjen e rënduar të këtyre qytetarëve, propozon që nga buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, konkretisht nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, të ndihmohen këto Ekonomi Familjare që kanë pasur dëme. Përkrahja financiare për secilën familje do të jetë në shumën prej 10.000.00 € (dhjetëmijë euro), në mënyrë që të lehtësojmë gjendjen e rënduar të qytetarëve tanë.

Pagesa do të bëhet në bazë të Raportit përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara tek Ekonomitë Familjare, i cili do të jetë pjesë përbërëse e këtij propozimi.

Shtojcë:

1x1 Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005239-15/24, dt. 31.01.2024;

1x1 Raporti i Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 02-052/01-0006238/24, dt. 26.01.2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005239-15/24 dt. 31.01.2024
Mitrovicë

02-060/01-0005239-15/24
31.01.2024

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 58, pika j, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); në nenin 37, 57, 90 dhe 91 të Ligjit Nr. 04/L-027 Për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera gazeta ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 22/2011); nenin 31 të Rregullores Nr. 17/2015 Për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 77, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 31.01.2024, pasi shqyrtoi Raportin mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës; sjell këtë:


VENDIM

Për miratimin e Raportit mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës

1. MIRATOHET Raporti mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës.
3. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës

02-052/01-0006230/24
26.01.24

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA	
	KOMUNA E MITROVICËS JUGORE OPSTINA J MITROVICA/ MUNICIPALITY OF S.MITROVICA/	

DATË/A:	
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Vesa Broja, Kryesuese e Kuvendit Komunal në Mitrovicës
cc:	Komiteti për politikë-financa
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bedri Hamza, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
NGA/OD/FROM:	1. Besim Beka-kryetar 2. Rexhep Hajdari-anëtar 3. Idriz Beqiri-anëtar 4. Jeton Bajrami-anëtar 5. Bahri Sinani-anëtar
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e rrëshqitjeve në territorin e Komunës së Mitrovicës

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 37, 57, 90 dhe 91 të Ligjit Nr. 04/L-027 pwr Mbrojtje nga Fatkeqwsit Natyrore dhe Fatkeqësit Tjera, neni 31 të Rregullores Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera si dhe në dokumentet tjera përcjellëse që kanë të bëjnë me menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera duke i përfshir të gjitha nomenklaturat që janë të paraqitura në raportet e komisioneve përfundimtarë për dëmet në ekonomi familjare, për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitjet e dheut si pasoj e shkaktarëve të evidentuar nga zyra e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës-bashkangjitur raporti i SHGJK-s me numër rendor 01\1-1365 të datës 13.04.2023, 01/1-4517 i datës 08.11.2023, raportit të ekipit vlerësues të AME-së të datës 26.06.2023 dhe procesverbalet e inspektoriatit, sektorit të ndërtimit (Drejtoria e Inspeksionit) i datës 01.09.2023 në Lagjen Bair konkretisht rrugët “Mustaf Shyti”, “Ali

Pashe Tepelena” si dhe më gjer në komunën e Mitrovicës Jugore të cilët kanë bërë konstatimin e dëmeve me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësis së dëmit në të mira materiale.

Po ashtu kemi të bashkangjitur edhe raportin preliminar të datës 29.06.23, nr protokoli 01\1-2192 nga zyrtari i lartë për gjeologji inxhinierike-shërbimi gjeologjik i Kosovës.

Po ashtu kemi të bashkangjitur fotografitë e matjeve Gjeodozike të bëra nga data 18.10.2022, 28.04.2023 dhe 23.08.2023

Evidentimi dhe konstatimi i dëmeve është organizuar në zonën e lagjës Bair dhe më gjer e cila ka pësuar dëme nga fatkeqësit natyrore konkretisht ka të bëjë me rrëshqitje të dheut.

Në menyrë që të bëhet vlerësimi më real i dëmeve të shkaktuara në shtëpitë e përfshiera në këto lokacione ne si komision duke u mbështetur në rregulloren për vlerësim të dëmeve propozojmë që në bashkëpunim me nivelin qendror (AME) të formohet një grup ekspertësh për vlerësimin e vlerës monetare, arsyeja se kemi të bëjmë me shtëpitë e dëmtuara në tërësi.

Lista e dëmeve në ekonomi familjare (shtëpitë e dëmtuara)				
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Komuna	Adresa	Vërejtje
1	Besim Hasani	Mitrovicë	Mustaf Shyti	
2	Bujar Avdiu	Mitrovicë	Mustaf Shyti	
3	Driton Nuli	Mitrovicë	Mustaf Shyti	
4	Muharrem Selmani	Mitrovicë	Mustaf Shyti	
5	Isuf Jashari-Bashkim Jashari	Mitrovicë	Mustaf Shyti	Babai I ka vdekur posedon certifikaten e vdekjes
6	Gezim Mustafa	Mitrovicë	Mustaf Shyti	
7	Lavdim Selmani	Mitrovicë	Mustaf Shyti	
8	Nazmije Jonuzi	Mitrovicë	Mustaf Shyti	
9	Sadri Maliqi	Mitrovicë	Ali Pashë Tepelena	
10	Sami Maliqi	Mitrovicë	Ali Pashë Tepelena	2 shtëpi
11	Rifat Peci	Mitrovicë	Tynel I Parë	
12	Xhevdet Cimili	Mitrovicë	Faruk Spahija	
13	Gazmend Maliqi	Mitrovicë	Mustaf Shyti	është në listen e Janarit 2023
14	Ramë Maliqi	Mitrovicë	Mustaf Shyti	është në listen e Janarit 2023
15	Nexhmedin Maliqi	Mitrovicë	Mustaf Shyti	është në listen e Janarit 2023
16	Muhamet Maliqi	Mitrovicë	Mustaf Shyti	është në listen e Janarit 2023